VENDIM
Nr.642, datë 21.5.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën "b", të pikës 1, të vendimit nr.53, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do t'i realizojnë vetë procedurat e prokurimit, për këto shërbime.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha